



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA



PLANI STRATEGJIK

2024-2028

Plani Strategjik 2024-2028
hartohet bazuar në Politikën për Planifikim Strategjik
në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Prishtinë,
Dhjetor 2023

Përmbajtja

Fjala hyrëse e Guvernatorit	4
Mandati	7
Misioni	9
Vizioni	10
Vlerat	11
Qëllimet Strategjike	12
➤ Forcimi i qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar	13
➤ Ngritja e kapaciteteve, përkushtimi ndaj personelit, digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve	14
➤ Modernizimi i infrastrukturës së tregut financiar dhe konkurrueshmëria	15
➤ Avancimi i mbrojtjes së konsumatorit, edukimi financiar dhe përfshirjes financiare	16
➤ Zgjerimi i bashkëpunimit, përfshirjes dhe ndikimit në fushat e përgjegjësive	17

Fjala hyrëse e Guvernatorit



Dr. Sc. Ahmet Ismaili

Guvernator i Bankës Qendrore
të Republikës së Kosovës

Të nderuar lexues,

Në një periudhë ku dinamika ekonomike dhe ndërvarësia globale, avancimet teknologjike dhe lëvizjet gjeopolitike ripërcaktojnë dinamikën e financave, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) do jetë aktive dhe do të adresojë me kohë veprimet e nevojshme në funksion të ruajtjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar dhe arritjen e objektivave tjera të BQK-së.

Objektivat e BQK-së, sikurse janë nxitja dhe ruajtja e një sistemi të qëndrueshëm financiar, si dhe një sistem të sigurt dhe efikas të pagesave, në mbështetje të politikave të përgjithshme ekonomike mbi bazën e një ekonomie të tregut të hapur me konkurrencë të lirë dhe përmes një shpërndarje efikase të resurseve, shërbejnë si bazë për prioritetet tona strategjike.

Plani Strategjik për periudhën 2024-2028 është hartuar me kontribut dhe gjithë-përfshirje të personelit të BQK-së. Plani merr parasysh të gjitha kërkesat e nevojshme të kohës dhe shërben si udhërrëfyes për të adresuar çështjet që lidhen me: (a) qëndrueshmërinë dhe stabilitetin financiar, (b) modernizimin e infrastrukturës së tregut financiar, (c) edukimin dhe përfshirjen financiare, (ç) avancimin e mbrojtjes së konsumatorit, si dhe (d) zgjerimin e bashkëpunimit dhe ndikimit në fushat e përgjegjësisë.

Njëkohësisht ky Plan Strategjik ka në fokus qeverisjen me integritet, përmirësimin e kulturës së organizatës, transparencën dhe komunikimin e hapur, rritjen e besueshmërisë, ngritjen e kapaciteteve, modernizimin e proceseve të BQK-së, të ndjekura me një shqyrtim përmbajtjesor të bazuar në praktikat dhe standardet më të mira të organizimit të brendshëm të BQK-së.

Plani Strategjik përbëhet nga pesë (5) objektiva dhe pesëdhjetë (50) veprime strategjike që udhëhiqen nga vizioni, misioni e vlerat e BQK-së dhe zotimi jonë për të forcuar qëndrueshmërinë e sistemit financiar, promovuar konkurrencën dhe gjithë-përfshirjen financiare, rritur transparencën dhe llogaridhënien si dhe për të ruajtur interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në funksion të realizimit të kësaj, do të punojmë në avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse të institucioneve financiare, si dhe në zhvillimin e infrastrukturës së tregut financiar, transformimit digjital të shërbimeve financiare duke ruajtur principet bazë të stabilitetit dhe sigurisë së sistemit financiar, bazuar në praktikat dhe standardet më të avancuara ndërkombëtare në nivelin që i përgjigjet nevojave dhe ekonomisë së vendit në përgjithësi.

Bashkëpunimi i ngushtë me të gjithë akterët vendor, përfshirë sektorin publik dhe privat, me të gjithë partnerët ndërkombëtar që na kanë mbështetur për arritjet e deritanishme si dhe me publikun e gjerë, do të jenë në qendër të qasjes tonë në funksion të adresimit të sfidave dhe forcimit të rritjes ekonomike. Prioritet do të jenë edhe iniciativat e Bashkimit Evropian për rajonin e Ballkanit Perëndimor, sa i përket harmonizimit të legjislacionit me Acquis, në përmbushje të kriterëve për anëtarësim në sistemet dhe skemën e pagesave të BE-së sikurse janë SEPA dhe TIPS, por edhe në fushat tjera.

Gjithashtu, do të punojmë në adresimin e rreziqeve kibernetike, atyre klimatike dhe të ambientit që mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e institucioneve financiare dhe stabilitetin financiar në përgjithësi. Këto veprime do të jenë në drejtim të forcimit të kornizës rregullative dhe direktivave të BE-së, standardeve të Bazelit dhe standardeve më të larta ndërkombëtare.

Të gjitha këto zhvillime do të jenë në funksion të rritjes së përfshirjes financiare të qytetarëve pa dallim, mbrojtjes së konsumatorëve, duke u mundësuar shërbime lehtësisht të qasshme, përfshirë qasjen e lehtësuar fizike, si dhe përmes formave të reja që aktualisht i mundëson teknologjia, në mënyrë më efikase dhe më të përballueshme. Gjithnjë duke ofruar informacionin dhe shpalosjet e nevojshme përmes aktiviteteve të edukimit financiar që do të ndërmerren në bashkëpunim me akterët tjerë, duke përfshirë aktivitetet e ndryshme të karakterit publik, si dhe hulumtimeve dhe publikimeve të tjera.

Në përfundim, ky Plan Strategjik është një shprehje e vizionit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe një kornizë dinamike që pasqyron dedikimin tonë ndaj qëndrueshmërisë së sistemit financiar, inovacionit në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve financiare dhe mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës. I njëjti ka marrë parasysh rekomandimet nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare si partnerë strategjik, me theks të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, të dala nga misionet dhe vlerësimet e tyre për BQK-në dhe sektorin financiar.

Me këtë rast, shpreh falënderimet më të sinqerta për të gjithë personelin i cili ka kontribuar në hartimin e këtij plani strategjik, Bordin Drejtues të BQK-së për përkrahjen dhe orientimet strategjike të mishëruara në këtë plan si dhe partnerët strategjik për mbështetjen dhe kontributin e tyre.

Me konsideratën më të lartë,

Ahmet Ismaili
Guvernator i BQK-së



Mandati



Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është subjekt juridik dhe publik i pavarur me kompetencë të plotë bazuar në Nenin 11 dhe 140 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjin 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (me tutje Ligji për BQK-në).

BQK është subjekt juridik publik që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese.

Objektivi parësor i BQK-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Objektivi shtesë i BQK-së, i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj, është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore.

Po ashtu, pa paragjykuar arritjen e këtyre objektivave, BQK-ja mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregu të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.

Detyrat e BQK-së në arritjen e objektivave të përcaktuara përfshijnë:

- Përcaktimin dhe zbatimin e politikave të një sistemi financiar stabil duke përfshirë mbikëqyrjen e një skeme të sigurimit të depozitave, kryerjen e operacioneve të tregut, si dhe ofrimin e likuiditetit emergjent;
- Rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare ashtu si specifikohet më tej në Ligjin për BQK-në apo ndonjë ligj tjetër;
- Promovimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të sigurta, të qëndrueshme dhe efikase të pagesave, të kliringut dhe të shlyerjes së Letrave me Vlerë;
- Sigurimin e një furnizimi të duhur të kartëmonedhave dhe monedhave në Republikën e Kosovës;
- Mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave ndërkombëtare;
- Mbledhjen dhe publikimin e statistikave;
- Angazhimin në arritjen dhe mbajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore;
- Informimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe publikut të gjerë rreth politikave, detyrave dhe operacioneve të saj;
- Veprimin si bankier, këshilltar financiar dhe agjent fiskal për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe çdo organ publik dhe organizatë publike të Republikës së Kosovës;
- Bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në këshillat dhe organizatat ndërkombëtare, përkitazi me çështje brenda fushës së saj të kompetencave; dhe
- Realizimin e çdo aktiviteti ndihmës që rrjedh nga ushtrimi i detyrave të saj.

Organet vendimmarrëse të BQK-së janë Bordi i Bankës Qendrore, Bordi Ekzekutiv dhe Guvernatori.

Misioni



Misioni ynë është të sigurojmë stabilitet financiar dhe monetar, të ofrojmë sistem efektiv të pagesave dhe furnizim adekuat me para të gatshme, si dhe të mbështesim zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në Republikën e Kosovës.

Vizioni



Ne përkushtohemi
të jemi institucion i pavarur dhe i besueshëm
që punon në mënyrë transparente
dhe të përgjegjshme ndaj publikut,
si dhe të jemi sinonim i profesionalizmit,
inovacionit dhe gjithë-përfshirjes.

Vlerat



Integriteti dhe Etika



Kompetenca dhe Profesionalizmi



Puna në Grup dhe Inovacioni



Promovimi i Interesit Publik




Efektiviteti dhe Efikasiteti



Cilësia dhe Përkushtimi



Qëllimet Strategjike



Qëllimi 1

Forcimi i qëndrueshmërisë dhe stabilitetit financiar

Avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për të identifikuar dhe reaguar me kohë ndaj rreziqeve të institucioneve financiare në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar.

Veprimet

- 1.1. Zhvillimi i kornizës rregulluese dhe zbatuese të mbikëqyrjes makroprudenciale;
- 1.2. Avancimi i praktikave të mbikëqyrjes të institucioneve financiare;
- 1.3. Harmonizimi me kornizën rregullative të Bashkimit Evropian, standardet e Bazel-it, Solvencës, si dhe praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare;
- 1.4. Fuqizimi i mbikëqyrjes së sistemeve dhe instrumenteve të pagesave të rëndësishme sistemike, përfshirë FinTech-ët;
- 1.5. Zhvillimi i modeleve dhe instrumenteve për vlerësim të rrezikut sistematik, duke përfshirë rreziqet klimatike dhe të ambientit;
- 1.6. Krijimi i funksionit të BQK-së si autoritet i rimëkëmbjes dhe përmbylljes për bankat dhe degët e bankave të huaja si dhe fuqizimin e kornizës për mbështetje emergjente për likuiditet dhe skemës së garantimit të depozitave;
- 1.7. Zhvillimi i kornizës rregullative dhe kapaciteteve për ndërtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të kapitalit;
- 1.8. Avancimi i kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse për PPP/FT dhe pajtueshmëri;
- 1.9. Avancimi i kornizës rregullative për licencimin e institucioneve, miratimin dhe kompensimin e drejtuesve, kërkesave për miratim të pozitive kyçe dhe qeverisjes korporative; dhe
- 1.10. Mbështetja e aktiviteteve që ndikojnë në diversifikimin e burimeve të financimit, konkurrencës dhe qasjes në financa.

Qëllimi 2

Ngritja e kapaciteteve, përkushtimi ndaj personelit, digjitalizimi dhe modernizimi i proceseve

Modernizimi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në funksion të ngritjes së nivelit të qeverisjes korporative, kapaciteteve njerëzore, kontrollës së brendshme, menaxhimit të riskut, transparencës, proceseve dhe operacioneve të punës.

Veprimet

- 2.1. Përmirësimi i kulturës dhe qeverisjes korporative;
- 2.2. Ngritja e kapaciteteve njerëzore, menaxhimi i talentit;
- 2.3. Përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullativ të BQK-së, duke ndjekur standarde të larta etike dhe të integritetit;
- 2.4. Përmirësimi i sigurisë kibernetike dhe rritja e gatishmërisë ndaj rreziqeve kibernetike dhe kapaciteteve virtuale të ruajtjes së informacionit si dhe integrimi i teknologjive të inteligjencës artificiale;
- 2.5. Zhvillimi dhe avancimi i kornizës dhe proceseve gjithëpërfshirëse të kontrollit të brendshëm të menaxhimit të rrezikut;
- 2.6. Digjitalizimi dhe automatizimi i operacioneve, mbështetja e nënshkrimit elektronik dhe proceseve të brendshme të autorizimit;
- 2.7. Krijimi i kushteve të punës që tërheqin dhe mbajnë personel të profileve adekuate;
- 2.8. Krijimi dhe zhvillimi i funksionit të analizave dhe hulumtimeve empirike;
- 2.9. Avancimi dhe konsolidimi i regjistrave të brendshme të BQK-së, si dhe ndërveprimi me sisteme të institucioneve për shkëmbim të të dhënave në interes publik; dhe
- 2.10. Orientimi drejt zbatimit të parimeve ESG në operacionet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Qëllimi 3

Modernizimi i infrastrukturës së tregut financiar dhe konkurrueshmëria

Avancimi i infrastrukturës për shlyerjen e pagesave dhe Letrave me Vlerë dhe për digjitalizimin e shërbimeve të pagesave në funksion të nxitjes së konkurrencës dhe zhvillimit të tregut.

Veprimet

- 3.1. Zhvillimi i infrastrukturës, rritja e sigurisë dhe efikasitetit për shlyerjen e pagesave dhe Letrave me Vlerë, menaxhimin e kolateralit dhe ndërveprimin e sistemeve;
- 3.2. Avancimi i kornizës ligjore dhe rregullative në vend lidhur me fushën e shërbimeve të pagesave në drejtim të harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, PFMI dhe standardet tjera ndërkombëtare;
- 3.3. Zhvillimi i infrastrukturës teknike për mundësimin e pagesave të shpejta 24/7, krijimi i QR Kodit kombëtar dhe standardizimi i API-së për ndërlidhje të sistemeve;
- 3.4. Avancimi i kornizës rregullative për fushën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit lidhur me shërbimet e pagesave;
- 3.5. Mbështetja aktive në zhvillimin e tregut të kapitalit së bashku me akterët tjerë të tregut;
- 3.6. Ndërtimi i kornizës rregullative dhe kapaciteteve që mundësojnë adresimin e kërkesave për shërbime dhe forma të reja inovative, të ofrimit dhe testimit të tyre;
- 3.7. Mundësimi i qasjes në Platformat Ndërkombëtare të Pagesave;
- 3.8. Reduktimi i pagesave me para të gatshme si dhe promovimi i pagesave elektronike;
- 3.9. Krijimi i mundësive për qasjen në sistemin e pagesave të ofruesve të shërbimeve jo-bankare, si dhe mundësimi i posedimit të IBAN-it, për të rritur qasjen në financa, në kuadër të konceptit të "llogarisë për pagesa";
- 3.10. Avancimi i infrastrukturës ligjore dhe teknike të BQK-së për anëtarësim në Skemën e Pagesave SEPA dhe qasje në Sistemin e Pagesave të Shpejta të Bashkimit Evropian (TIPS);
- 3.11. Zhvillimi i aktiviteteve lidhur me Monedhën Digjitale të Bankës Qendrore (CBDC); dhe
- 3.12. Rregullimi dhe mbikëqyrja e institucioneve që ofrojnë shërbime lidhur me kripto-asete.

Qëllimi 4

Avancimi i mbrojtjes së konsumatorit, edukimi financiar dhe përfshirjes financiare

Promovimi i edukimit financiar, qasjes në financa dhe gjithë-përfshirjes financiare si dhe praktikave më të mira të ofrimit të shërbimeve nga institucionet financiare.

Veprimet

- 4.1. Krijimi i funksionit të shqyrtimit të praktikave të ofrimit të shërbimeve financiare dhe avancimi i trajtimit të ankesave;
- 4.2. Krijimi i kornizës mbikëqyrëse për institucionet financiare lidhur me praktikatat e ofrimit të shërbimeve financiare;
- 4.3. Avancimi i kornizës mbikëqyrëse për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve për shërbimet financiare;
- 4.4. Avancimi i komunikimit me publikun dhe ngritja e transparencës së BQK-së;
- 4.5. Organizimi dhe pjesëmarrja në ngjarje dhe aktivitete të edukimit financiar, për të lehtësuar dhe mbështetur gjithë-përfshirjen financiare;
- 4.6. Zhvillimi i materialeve dhe avancimi i faqes së internetit të BQK-së që mundëson krahasimin e shërbimeve financiare dhe kostos së tyre;
- 4.7. Organizimi i diskutimeve me medie dhe institucionet financiare, përfshirë shoqatat e konsumatorëve dhe bizneseve;
- 4.8. Promovimi i praktikave të mira të mbrojtjes së konsumatorëve të shërbimeve financiare dhe shpalosjes së drejtë të shërbimeve;
- 4.9. Lehtësimi i qasjes fizike të pakufizuar për të gjitha grupet shoqërore në ofrimin e shërbimeve në degët dhe pikat e ofrimit të produkteve; dhe
- 4.10. Bashkëpunimi me akademinë dhe organizatat profesionale të tjera si dhe pjesëmarrja në aktivitete të edukimit financiar dhe nisma rajonale.

Qëllimi 5

Zgjerimi i bashkëpunimit, përfshirjes dhe ndikimit në fushat e përgjegjësisë

Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me akterët e jashtëm, institucionet financiare, autoritetet rregullatore, institucionet financiare ndërkombëtare dhe institucionet tjera përkatëse me interes të përbashkët.

Veprimet

- 5.1. Zgjerimi i bashkëpunimit me banka të reja korrespondente për menaxhimin efikas të rezervave ndërkombëtare;
- 5.2. Pjesëmarrja në iniciativat e përbashkëta me autoritetet rregullatore rajonale e më gjerë me fokus në fushat me interes të përbashkët;
- 5.3. Zgjerimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me autoritetet e ngjashme rajonale dhe ndërkombëtare;
- 5.4. Bashkëpunimi me institucione akademike, institute kërkimore dhe shoqata profesionale;
- 5.5. Anëtarësimi në organizata, rrjete, iniciativa, shoqata rajonale dhe ndërkombëtare;
- 5.6. Angazhimi drejt anëtarësimit në Këshillin e Byrove (Kartoni i Gjelbër);
- 5.7. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore, institucionet financiare dhe subjektet tjera;
- 5.8. Fuqizimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave si organ këshillues për veprime të përbashkëta rreth digjitalizimit dhe standardizimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave;
- 5.9. Krijimi i një trupe këshillëdhënëse apo liste të eksperteve të jashtëm me ekspertizë të veçantë; dhe
- 5.10. Bashkërendimi dhe mbështetja e nismave në fushën e ESG-së.



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Adresa

Garibaldi 33
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Telefon

+383 (0) 38 222 055

E-Mail

info@bqk-kos.org

Web

<http://www.bqk-kos.org>

